



Datë: 22.04.2025

Numër protokolli: 2680/2025

A.nr.337/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Flakron Gashi-në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.337/2025 të datës 19.02.2025 të parashtruar nga ankuesi R.G, kundër organit të punësimit/Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 22.04.2025 mori:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.337/2025, e datës 19.02.2025, e parashtruara nga ankuesi R.G.

II. Shfuqizohet Njoftimit i datës 24.01.2025 i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve të SHKK-së, ndërsa **Anulohet** në tërësi procedura e rekrutimit e shpallur sipas konkursit të datës 21.10.2024 me numër të Referencës RN00015414 për pozitën “Drejtor i Qendrës së Paraburgimit në Gjilan” në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës që të ndërmerr të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën **II** të dispozitivit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Ankuesi R.G, (tutje referuar vetëm ankuesi), nëpërmjet e-mailit zyrtar ankesa.kpmschk@rks-gov.net me datë 19.02.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me numër protokolli 1114/2025, nën shenjë A.nr.337/2027, kundër Njoftimit të datës 24.01.2025 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës, lidhur me procedurën e rekrutimit për pozitën “Drejtori i Qendrës së Paraburgimit në Gjilan” në kuadër të SHKK-së, për shkak të refuzimit të aplikacionit të tij në fazën e verifikimit paraprak.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.02.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 21.02.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës me shkresat e bashkangjitura të lëndës . Më datë 27.03.2025 përmes vendimit VK/2025, kryetari i këshillit i ka vazhduar afatin e vendimmarrjes edhe për 10 ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 1114/2025 e parashtruar nga ankuesja më datën 19.02.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 04.12.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të SHKK-së; Diplomën e datës 22.12.2015; Vërtetimin e datës 27.06.2024; Vërtetimin e datës 28.06.2024; Çertifikatë e datës 10.06.2005; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; E-mail i datës 19.02.2025; Formular për regjistrimin e ankesave i datës 19.02.2025; Kërkesa për përgjigje në ankesë 21.02.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 21.02.2025; Konkursin e datës 21.10.2024; vendimin e datës 11.12.2024 të drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së për themelimin e Komisionit të Pranimi si dhe akt emërimet dhe vendimet për emërimin e tyre; Vendimin e datës 23.11.2022 i Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimin e datës 27.02.2024; Akt Emërimi i datës 17.11.2022; Akt Emërimin e datës 09.12.2022; Akt Emërimin e datës 05.05.2023; Njoftimin e datës 06.12.2024; Aplikacionin e kandidatët të suksesshëm i datës 11.11.2024 me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacionin ankuesit, i datës 20.11.2024 me dokumentacionin e bashkangjitur; Lista e përfundimtare e vlerësimit të kandidatëve i datës 24.10.2025; Njoftimin e datës 24.01.2025 për kandidatin e suksesshëm; Raporti për renditjen përfundimtare: kërkesën e datës 25.03.2025; Përgjigjen e datës 01.04.2025; vendimi VK/2025, i datës 27.03.2025.

Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e bazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se Shërbimi Korrektues i Kosovës, më datë 21.10.2024 ka shpallur konkursin me numër reference RN00015414, për pozitën “Drejtor i Qendrës së Paraburgimit në Gjilan” Drejtues i Mesëm, ku afati për aplikim ka qenë nga data 22.10.2024 deri më 20.11.2024, ndërsa sipas shkresave të lëndës, në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, mirëpo

Njësia e Burimeve Njerëzore përmes Vendimit të datës 04.12.2024 ia ka refuzuar aplikacionin me arsyetimin se i njëjti nuk i plotëson kriteret e përvojës drejtuese pas diplomimit.

Pas përfundim të fazave të vlerësimit, Njësia e Burimeve Njerëzore e SHKK-së, më datë 24.01.2025, ka publikuar njoftimin për vlerësimin e rezultateve përfundimtare të kandidatëve, ashtu që kandidati suksesshëm rezulton të jetë R.S me gjithsejtë 87.2 pikë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër veprimeve të Njesisë së Burimeve Njerëzore të SHKK-së, për shpalljen e kandidatit fitues, respektivisht refuzimit të aplikacionit të tij, i njëjti pretendon se është vepruar në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr.15/2023 për Procedurat e Pranimi në Shërbimin Civil, ashtu që Këshilli të shfuqizo aktin e kontestuar si të paligjshëm ndërsa t'ia mundësoj të njëjtit kandidimin në procedurën e kontestuar me arsyetimin se i plotëson kriteret e përvojës së punës pasi që nga data 10.06.2005 e deri me datë 31.01.2008 kamë qenë i zgjedhur Zëvendës Drejtor i Qendrës së Paraburgimit në Gjilan, ndërsa nga data 01.08.2008 e ushtrojë pozitën e mbikëqyrësit të lartë si dhe kam të përfunduar Fakultetin Juridik.

Kolegji i Këshillit, para se të lëshohet në shqyrtimin e pretendimeve ankimore, duke u bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, fillimisht ka analizuar ligjshmërinë e shpalljes së procedurës së pranimi me Nr.reference RN00015414, për pozitën Drejtor i Qendrës së Paraburgimit në Gjilan të shpallur nga SHKK, dhe ka konstatuar se për këtë pozitë të punës si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar: **Arsimimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor). Kërkesat specifike: Dëshmi, Certifikata, e njohjes së Gjuhës Anglezë; Përvoja e punës e kërkuar: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale duke përfshirë njërin nga kërkesat në vijim:c.1.) tre (3) vite përvojë pune në pozita drejtuese, ose c.2.) dy (2) vite përvojë punë në pozita drejtuese dhe diplomë të nivelit të dytë të arsimit të lartë (master),ose c.3.) një (1) vit përvojë punë në pozita drejtuese dhe diplomë të nivelit të tretë të arsimit të lartë (doktoraturës).**

Duke marrë parasysh dispozitat e aplikuara të ligjit material, respektivisht nenit 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe paragrafi 2 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: **“1. Nëpunësja/i civil me status të veçantë është nënkategori e nëpunëses/it civil, ku bëjnë pjesë: 1.1. të punësuarat/it e shërbimit korrektues dhe sprovues të Kosovës; 2. Rregullimi me ligj të veçantë për nëpunësen/in civil me status të veçantë, sipas paragrafit 1. të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm elementet e marrëdhënies së punës, si në vijim: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. trajnimet dhe zhvillimin profesional; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve; 2.6. përcaktimin e shkelleve dhe masave disiplinore shtesë; 2.7. disiplinën dhe vlerësimin.”**, Kolegji i Këshillit mori për bazë dispozitat e aplikuara të Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, Rregulloren (ZKM)-NR.18/2024 Për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Udhëzimit Administrativ MD-Nr.07/2024 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues dhe konstatoi se aktet në fjalë respektivisht legjislacioni i veçantë për

Shërbimin Korrektues të Kosovës, nuk ka përcaktuar apo nuk ka rregulluar ndryshe çështjen e aprovimit të kriterëve specifike dhe përshkrimit të detyrave të punës.

Lidhur me konstatimin e dhënë si më lartë, Kolegji i Këshillit duke marrë për bazë dispozitat e nenit 2 Rregullores Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, konstatoi se Shërbimi Korrektues i Kosovës nuk përjashtohet nga fusha e zbatimit të kësaj rregulloreje, nga rrjedh se SHKK, në secilin rast të përshkrimit aprovimit të detyrave dhe kriterëve për pozitat përkatëse duke përfshirë edhe ato specifike, duhet të ndjek procedurën e përcaktuar sipas nenit 21 paragrafi 5 të së njëjtës rregullore ku përcaktohet se: *“Përshkrimi i vendeve të punës miratohet nga drejtuesi më i lartë administrativ i institucionit, pas pëlqimit nga DMZP, për institucionet e administratës shtetërore. Ndërsa institucionet tjera, mund të kërkojnë mendim këshillimor në DMZP para miratimit nga drejtuesi më i lartë administrativ i institucionit”*, pasi që Shërbimi Korrektues i Kosovës, sipas përcaktimeve ligjore të nenit 5 të Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, e ka statusin e Agjencisë Ekzekutive dhe hynë në kuadër të kategorizimit **Institucion i Administratës Shtetërore** sipas përkufizimeve ligjore të përcaktuara me nenin 4 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Duke marrë për bazë konstatimin e dhënë si më lartë, meqenëse në cilësi të provave materiale SHKK ka dërguara aprovimin e datës 18.10.2024 të përshkrimit të detyrave të punës dhe kriterëve të pozitës përkatëse duke përfshirë edhe përcaktimin e kriterëve specifike, Kolegji i Këshillit me shkresë zyrtare (e-mailin e datës 15.04.2025) i është drejtuar Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/DMZP-së me kërkesën për sqarim, citoj: *“... a mund të na e konfirmoni faktin nëse Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/DMZP ka dhënë pëlqimin zyrtar, lidhur me përcaktimin e kriterëve specifike për pozitën në fjalë nga ana e SHKK-së, sikurse përcaktohet me dispozitat e aplikuara të nenit 21 paragrafi 5 të Rregullores Nr.06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.”*, kurse Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik përmes e-mailit të datës 15.04.2025 ka kthyer përgjigje si në vijim, citoj: *“Ju njoftojë se DMZP nuk ka pranuar kërkesë e rrjedhimisht as nuk ka ofruar pëlqim për përshkrimin në fjalë”*.

Prandaj, duke marrë për bazë dispozitat e aplikuara nga neni 19, 20 dhe 21, paragrafi 2, nën paragrafi 2.4 i Rregullores Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: *“19. Kërkesat e përgjithshme formale, përfshijnë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës që janë të domosdoshme për kryerjen me sukses të detyrave dhe përgjegjësi. 20.1. Kriteret specifike, për pozita të caktuara, mundet të përcaktohen vetëm gjatë procesit të miratimit të përshkrimit të vendit të punës. 20.2. Kriteret specifike mund të përcaktojnë kualifikimin, licencimin dhe/apo certifikimin e posaçëm që kërkohet për pozitën përkatëse; dhe 21.2.4. Përshkrimi i punës shërben për: përcaktimin e kriterëve për çdo pozite pune në shërbimin civil”* Kolegji i Këshillit konstatoi se vënia e kriterëve specifike (njohja e gjuhës angleze) në konkursin e datës 21.10.2024 me numër reference RN00015414, për pozitën *“Drejtor i Qendrës së Paraburgimit në Gjilan”* pa ndjekur procedurën ligjore për aprovimin e tyre sikurse përcaktohet me dispozitat e lartcekura të Rregullores Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, është veprim që bie ndesh me parimet e përgjithshme të pranimi sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 7 ndërlidhur me paragrafin 2 të nenit 9 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ngase nuk mund

të përcaktohen apo parashihen kritere specifike në shpalljen e konkurseve për pozitat përkatëse, nëse paraprakisht kriteret e tilla nuk janë të përshkruara dhe miratuara nga drejtuesi më i lartë administrativ i institucionit, pas pëlqimit të dhënë nga DMZP.

Kolegji i Këshillit, me qëllim të konstatimit të gjendjes faktike lidhur me përcaktimin e kritereve specifike në lidhje me konkursin e datës 25.03.2025 i është drejtuar Njesisë së Burimeve Njerëzore të SHKK-së me kërkesën për prova shtesë si në vijim: *“Aprovimin e përshkrimit të detyrave të punës dhe kritereve të përcaktuara, duke përfshirë edhe aprovimin e kritereve specifike lidhur me njohjen e gjuhës angleze, për pozitën Drejtor i Qendrës së Paraburgimit në Gjilan.”*, ndërsa kjo e fundit me datë 01.04.2025 në sqarimin e dhënë si arsyetim e përmendin faktin se Shërbimi Korrektues i Kosovës/Ministria e Drejtësisë/Republika e Kosovës ka lidhur marrëveshje me Mbretërinë Danimarkës për dhënin me qira të Qendrës së Paraburgimit të Gjilanit, mirëpo Kolegji i Këshillit nuk ia fali besimin kësaj shkresë, pasi që nëpërmjet së njëjtës nuk është provuar me asnjë fakt se përcaktimi i kritereve specifike për këtë pozitë ta ketë ndjekur procedurën ligjore për aprovimin paraprak, sikurse përcaktohet me dispozitat e kuadrit ligjor në fuqi të cekura si më lartë, ndërsa Kolegji i Këshillit thekson faktin se arsyetimi i Shërbimit Korrektues të Kosovës si në shkresën e dhënë të datës 01.04.2025, ka mundur të përdoret si argument apo arsyetim lidhur me aprovimin e kritereve specifike në fjalë, mirëpo vetëm pasi të këtë shteruar hapat procedural të përcaktuar si në Rregulloren Nr.06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Andaj, duke marrë për bazë konstatimet e dhëna si më lartë, dhe meqenëse Kolegji i Këshillit konstatoi se në këtë procedurë të rekrutimit shkeljet janë evidentuar qysh me rastin e shpalljes së konkursit të datës 21.10.2024, ashtu që nuk janë përfillur procedurat ligjore lidhur me përcaktimin e shpalljes së kritereve specifike, të përcaktuara si në arsyetimin e këtij vendimi, dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 53 dhe nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme administrative, me qëllim të kthimit të ligjshmërisë vendosi sikurse në dispozitivin e këtij vendimi që të anuloi konkursin e datës 21.10.2024 me numër të Referencës RN00015414, për pozitën *“Drejtor i Qendrës së Paraburgimit në Gjilan”* dhe të shfuqizoi çdo akt dhe veprim tjetër procedural që ndërlidhet me konkursin në fjalë.

Kolegji i Këshillit thekson faktin se meqenëse konstatoi paligjshmërinë e aktit të shpalljes së konkursit në fjalë, nuk u lëshua në shqyrtimin e pretendimeve të tjera ankimore të ankuesit të parashtruar si në ankesën e datës 19.02.2025, pasi që konstatimi nëse pretendimet janë apo jo të bazuara nuk do ta ndryshonin natyrën vendimmarrëse të kësaj çështje administrative, ndërsa ankesa e ankuesit është aprovuar vetëm për arsyet e dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.337/2025, datë 22/04/2025

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit R.G;
- Shërbimit Korrektues të Kosovës (Drejtorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore),
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik-DMZP/MPB; si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.